



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 5 prot.

Kamëz, më 17. 1.2021

V E N D I M

Nr. 5 Datë 17/1 2021

MBI

KRIJIMIN DHE ORGANIZIMIN E NDËRMARRJES SË SHËRBIMEVE PUBLIKE

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 17.1.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.05 Datë 14.1.2022 në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Kushtetutës; nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1 nënpika 1.1, shkronjat “b” dhe “ç”, nenit 33 shkronja “a” nenit 54, nenit 55 pika 2 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 113 pika 3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së shqipërisë”; Ligjit nr. 7582 datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”; Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”; VKB nr. 132 datë 22.12.2021 “Për miratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2022, 2023, 2024”; Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e krijimit dhe organizimit të ndërmarrjes së shërbimeve publike.
2. Krijimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike si institucion në varësi të Bashkisë Kamëz me një numër total prej 53 (pesëdhjetë e tre) punonjësish;
3. Detyrat kryesore funksionale të këtij institucioni janë realizimi i administrimit, menaxhimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të rrugëve kryesore dhe jo kryesore, trotuarëve dhe bordurave kufizuese, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e sistemeve të ndriçimit publik, modernizimin e rrjetit të sinjalistikës rrugore, dhe administrimin e hapsirave për parkim;
4. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike mund të ofrojë shërbime me pagesë kundrejt subjekteve të treta, publike apo private, në përputhje me qëllimin e krijimit dhe veprimtarinë e saj;
5. Mënyra e përlllogaritjes së tarifave të shërbimeve specifike, që u ofrohen subjekteve të treta, do përcaktohen me Vendim të Këshillit Bashkiak;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

6. Ngarkohen Drejtoria e Financës; Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

**Kryetar Këshilli  
Hysen Koldashi**

